



Modul për gazetarët dhe mediat
Antigjipsizmi në Kosovë dhe raportimi i përgjegjshëm dhe etik
për rastet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Projekti:
Drejtësia Sociale për
Rom, Ashkali dhe Egjiptian



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO



Terre des hommes
Ndihmë për fëmijët.



Modul për gazetarët dhe mediat

**Antigjipsizmi në Kosovë dhe raportimi i përgjegjshëm dhe etik
për rastet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**

Qershor 2023



Mirënjohje

Moduli i Trajnimit të Trajnerëve mbi Antigjipsizmin është hartuar me mbështetjen e projektit "Drejtësia Sociale për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian". Projekti zbatohet nga Terre des Hommes Laussane në Kosovë në partneritet me organizatën Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE) dhe Swiss Church Aid (HEKS/EPER), si dhe financohet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (Swiss Cooperation Agency).

Moduli i trajnimit të trajnerëve është rezultat i një bashkëpunimi shumë të suksesshëm me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës (AGK), të cilët i falënderojmë për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e tyre për ta bërë modulin mbi antigjipsizmin në Kosovë pjesë të kurrikulës së tyre dhe planit të trajnimeve.

Moduli i trajnimit mbi Antigjipsizmin në Kosovë dhe raportimin e përgjegjshëm dhe etik për rastet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian është hartuar nga ekspertja e angazhuar, Znj. Serbeze Haxhiaj, e cila përveç se ka hartuar modulin e trajnimit gjithashtu ka mbajtur edhe sesionet e trajnimeve me gazetarë.

Përmbajtja

1. Të kuptuarit e antigjipsizmit: komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në media	7
1.1 Konteksti historik e social i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.....	9
1.2 Mediat dhe përgjegjësia	10
1.3 Mediat sociale dhe rrjedha e racizmit.....	11
1.4 Trajtimi i antigjipsizmit në media	12
2. Roli i medias kundër gjuhës së urrejtjes dhe paragjytimeve	15
2.1 Urrejtja e heshtur.....	17
2.2 Kur intervistoni një rom, ashkali apo egjiptian	17
2.3 Raportimi për fëmijët - obligimet etike.....	18
3. Lufta ndaj marginalizimit dhe përjashtimit social	21
3.1 Pësia e gjuhës së përdorur.....	22
3.2 Raportimi që shmang stereotipet.....	22
3.3 Portretizimi në media i romëve, ashkalive edhe egjiptianëve - raportimi mbi varfërinë.....	23
4. Roli i rregullatorëve të mediave në luftimin e diskriminimit	26
4.1 Komunikimi parasocial.....	27
4.2 Lista e verifikimit të diversitetit.....	27
4.3 Raportimet solidarizuese dhe gjërat që bashkojnë.....	28
4.4 Portretizimi në media i romëve, ashkalive edhe egjiptianëve	29
5. Referencat.....	30

Qëllimi dhe objektivat e modulit

Terre des Hommes Laussane në Kosovë është duke e zbatuar projektin "Drejtësia sociale për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët në Kosovë", në partneritet me organizatën Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE) dhe Swiss Church Aid (HEKS/EPER).

Vizioni dhe qëllimi i përgjithshëm i konsorciumit është një shoqëri multietnike dhe multikulturore në Kosovë, ku pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian trajtohen si të barabartë nga shteti dhe nga shoqëria, kanë qasje dhe mundësi të barabarta sikur të gjithë qytetarët e tjerë dhe ku romët, ashkalitë dhe egjiptianët njohin të drejtat dhe detyrat e tyre.

Përmes një sërë veprimesh avokuese, konsorciumi ka ndikuar në ndërtimin e kornizës ligjore dhe politikave Qeverisë, si dhe ka ndikuar në marrjen e vendimeve që kanë avancuar përfshirjen sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Duke mobilizuar bashkëpunëtorët në nivel lokal dhe nacional, konsorciumi krijoi me sukses sinergjinë e nevojshme për të rritur dhe avancuar politikave dhe integrimin institucional të intervenimeve që tashmë ishin testuar dhe zbatuar me sukses.

Një nga objektivat e këtij projekti është luftimi i "Antigjipsizmit" si formë specifike e diskriminimit racor ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional për trajtimin e këtij fenomeni, me anë të dialogut për politika, mbështetjes teknike dhe ngritjes së kapaciteteve.

Gjatë fazës së parë të implementimit të projektit, konsorciumi ka ofruar trajnime mbi Antigjipsizmin për zyrtarët publikë, mësuesit dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve. Meqenëse mediat kanë rol të rëndësishëm në ekspozimin e rasteve të Antigjipsizmit dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke ofruar një platformë për ata që janë prekur prej tij për të treguar historitë e tyre, në këtë fazë planifikohen të mbahen trajnime edhe për gazetarët dhe profesionistët e medias.

Ky modul trajnimi ka për synim që gazetarët të njoftohen me termin dhe elementet e Antigjipsizmit, rolin e mediave në luftimin e tij, të përmirësojnë nivelin profesional si dhe nëpërmjet mediave ta rrisë ndërgjegjësimin në raport me shkallën e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Duke zhvilluar forma interaktive të punës së studentëve dhe gazetarëve të profileve të ndryshme të mediave, kjo do t'i ndihmojë ata të diskutojnë raste praktike, të shkëmbejnë përvoja dhe të zgjerojnë rrjetin e kontakteve profesionale.

Në zemër të këtij moduli është përpjekja për ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve dhe mediave mbi raportimin e përgjegjshëm dhe etik për rastet që ndërlidhen me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe adresimin dhe eliminimin e formave të Antigjipsizmit.

Duke aplikuar standarde profesionale e etike, materia e këtij moduli ndihmon në identifikimin dhe adresimin e diskriminimit dhe kontribuon në përmirësimin e raportimit medial dhe portretizimit më të mirë në media të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Ky modul ka për qëllim të ofrojë burime, rregulla dhe udhëzime që ndihmojnë profesionistët e medias për të ofruar informacion pa paragjykime dhe të bazuara në standarde profesionale.

Përmes këtij moduli synohet që studentët e gazetarisë, gazetarët e të gjitha mediave dhe zhanreve, ashtu si edhe fotoreporterët dhe kameramanët, të rrisin njohuritë mbi raportimin rreth Antigjipsizmit dhe formave të manifestimit të tij, diskriminimin racor dhe gjithashtu të rritet ndërgjegjësimi i gazetarëve për rolin e tyre në një shoqëri multietnike.

Objektiv i këtij moduli është krijimi i një instrumenti trajnimi dhe ndërgjegjësimi për mediat në fushën e trajtimit të barabartë të komuniteteve, rom, ashkali dhe egjiptian.

Moduli po ashtu synon të mbështesë punën e gazetarëve në interes të respektimit të parimeve të përcaktuara në kodin etik dhe të rrisë përfshirjen sociale të komunitetit rom, ashkali e egjiptian, duke ndihmuar procesin e përfshirjes dhe integritetit të tyre.

Materia e këtij moduli jep informacion mbi situatën e këtyre komuniteteve dhe diskriminimin në media, me të cilin përballen pjesëtarët e këtij komuniteti.

Moduli gjithashtu ofron më shumë ide për të luftuar paragjykimet dhe stereotipet që nxisin praktika diskriminuese në mesin e mediave.

Ky modul gjithashtu ka për qëllim të ofrojë modelet më të mira në raportim, në mënyrë që pakicat të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të eliminohen elementet e Antigjipsizmit.

Për të krijuar një ambient më të shëndoshë për bashkëjetesën mes komuniteteve, mediat luajnë një rol kyç në formësimin e opinionit dhe përfaqësimin e zërave më të marginalizuar në shoqëri. Në një shoqëri ku universi i manifestimeve të Antigjipsizmit është mjaft i gjerë, mediat kanë një përgjegjësi të veçantë për të mos nxitur Antigjipsizmin si një fenomen i rrënjosur kudo nëpër Ballkan, që ka ende një pranim të gjerë shoqëror dhe politik.

Në një shoqëri gjithnjë e më të polarizuar në Kosovë, nxitja e urrejtjes dhe gjuha e ndarjes po fitojnë vazhdimisht terren. Kjo i obligon mediat të gërmojnë, identifikojnë dhe raportojnë të gjitha paragjykimet dhe stereotipet që ndërliken me Antigjipsizmin.

Përmbajtja e këtij moduli është rezultat i një sërë hulumtimesh, konsultimesh të gjera me profesionistët e mediave, Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, organizatat që punojnë në mbrojtjen e të drejtave të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, si dhe aktivistë të të drejtave të njeriut në Kosovë.

Kjo përfshin intervista me gazetarë rom, ashkali e egjiptian, konsultime me përfaqësuesit e Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, përfaqësues të mediave kryesore në vend: RTK, KTV, RTV 21, KLAN, KALLXO.com si dhe intervista me organizatat që punojnë në mbrojtjen e të drejtave të romëve, si Voice of Roma, Ashkali dhe Egjiptians etj.

SESIONI I



Tabela 1.

Sesioni 1/Temat	Kohëzgjatja	Metodologjia
Të kuptuarit e Antigjipsizmit: Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në media		
1.1 Konteksti historik e social i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Platforma nacionale për mbrojtje nga diskriminimi	30 min	Për të ofruar një përmbledhje më të plotë të situatës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, në këtë sesion do të paraqitet një tablo e shkurtër e kontekstit historik e social të këtyre komuniteteve. Pjesa teorike do të përqendrohet në shpjegimin e materies që ofron platforma nacionale, si bazë pastaj për t'u hulumtuar dhe raportuar në forma që mund të ngrajnë vëmendjen e mediave dhe publikut ndaj diskriminimit apo Antigjipsizmit.
1.2 Mediat dhe përgjegjësia	30 min	Parimet bazë të të mësuarit do të përdoren për gazetarët dhe studentët që të njohin natyrën dhe diversitetin mes komuniteteve dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.
1.3. Mediat sociale dhe rrjedha e racizmit	30 min	Rastet studimore apo ato ilustruese do të përdoren për të shpjeguar taktikat e luftimit të diskriminimit në mediat sociale dhe internet, si dhe për të zhvendosur vëmendjen e mediave në tejkalimin e efekteve afatgjata të Antigjipsizmit.
1.4 Trajtimi i Antigjipsizmit në media	30 min	Trajnimi do të praktikojë se si gazetarët duhet të trajtojnë dhe kundërshtojnë stigmatizimin dhe gjuhën raciste në diskutimet publike: në media, veçanërisht në mediat sociale, duke nxitur kundër-narrativa për një shoqëri gjithëpërfshirëse.
Shembuj: Ushtrime praktike	45 min	

1. Objektivat:

- Prezantimi i elementeve të antigjipsizmit, format e manifestimit të tij dhe raportimi rreth antigjipsizmit;
- Prezantimi i elementeve kryesore të kontekstit historik e social të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Pasqyrimi i një paradigme të Antigjipsizmit në Kosovë, si dhe roli dhe përgjegjësia e mediave në trajtimin, raportimin dhe portretizimin e komuniteteve në Kosovë.

Rezultatet e pritura:

Njohuri për standardet profesionale mbi të drejtat e komuniteteve pakicë, kontekstit historik, social dhe kulturor, situatën aktuale dhe rolin e mediave në krijimin e një ambienti më të mirë. si dhe një pozitë më të avancuar të këtij komuniteti.

Njohuri më të mira për historinë, realitetin e këtyre komuniteteve, përgjegjësinë dhe rolin e mediave për të ofruar një raportim të drejtë që lufton ndarjet dhe diskriminimin.

1. Të kuptuarit e Antigjipsizmit: Media dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Antigjipsizmi perceptohet si një formë e veçantë e racizmit kundër romëve, ashkalive dhe egjiptianëve që është i ngjashëm, i ndryshëm dhe i ndërthurur me shumë lloje të tjera racizmi. Është një term që tashmë është pjesë e diskursit të zakonshëm për romët, ashkalitë dhe egjiptianët dhe ka hyrë në leksikon e pushtetit institucional gjithkund nëpër Evropë.

Antigjipsizmi është një term relativisht i ri për mediat dhe publikun, por në fakt shihet si një sinonim i diskriminimit racor. Në aspektin e përgjithshëm, ata nuk janë të integruar plotësisht në shoqëri, kanë qasje të limituar në arsim, punësim, jetën kulturore, sociale dhe politike. Në media, janë gjithashtu të nën-përfaqësuar, jo në ekran, por kudo tjetër në platformat mediale. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve shpesh u nënshtrohen formave të përbuzjes dhe përjashtimit, një qasje që ka në thelb një perceptim superioriteti karshi tyre.

Beteja për çrrënjosjen e Antigjipsizmit përfshin përpjekje për përmirësimin e përfaqësimit kulturor dhe politik të romëve dhe masa më të forta ligjore për të trajtuar këtë formë specifike të racizmit.

Margjinalizimi, përjashtimi dhe demonizimi të cilëve u nënshtrohen këto grupe etnike bazohet në racizëm, dhe në projeksionin e stereotipeve që përbëjnë mosnjohje kulturore e historike, dhe kjo shoqërohet me marginalizim. Papunësia është një çështje serioze në Kosovë dhe edhe më e rëndë për romët, ashkalitë dhe egjiptianët, dhe mos përfshirja e tyre është një faktor që kufizon mundësitë e punësimit të këtyre komuniteteve.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Kosovë jetojnë 8,824 romë, 15,436 ashkali dhe 11,524 egjiptianë, që përbën 2% të popullsisë së përgjithshme.

Dallimet mes tri komuniteteve janë komplekse dhe shumëdimensionale. Në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Qeverisë së Kosovës për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe Egjiptian në Shoqërinë Kosovare - 2022-2026, këto tri komunitete i bashkon një ekspozim i njëjtë ndaj diskriminimit, marginalizimit, varfërisë dhe dëmtimit mjedisor.¹

¹ https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41362&fbclid=IwAR3dQ-Pqx4SldU1pxbW_AQWb7od0NQTkgufry4u-7Dqp7C_SbuU38bUuC7

Objektivi numër 5 i kësaj strategjie i dedikohet më shumë Antigjipsizmit dhe formave të manifestimit të tij.

Në këtë objektiv theksohet luftimi i diskriminimit, racizmit, stigmatizimit, gjuhës së urrejtjes, dhunës së urrejtjes dhe bullizmit në shkolla, si dhe promovimi i kulturës dhe historisë së komuniteteve rom dhe ashkali.

Platforma nacionale për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është një platformë për raportimin e rasteve e themeluar nga projekti i Terre Des Hommes në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë – Zyrën e Kryeministrit. Mediat mund ta përdorin këtë platformë për t'u informuar dhe për gërmuar më shumë rreth diskriminimit. Për faktin që gazetarët shpesh i shohin apo adresojnë raste të antigjipsizmit, ata mund ta përdorin këtë platformë si mjet për t'i adresuar rastet diskriminuese gjithashtu.

Këto tri komunitete kanë më pak qasje në punësim, jetën politike, kulturore, arsimore e kulturore, e sidomos vështirësi për të vijuar mësimin dhe për të arritur nivel universitar.

Në mesin e popullsisë shumicë, ato vazhdojnë të notojnë në një ujë diskriminimi, sidomos diskriminimi të "heshtur", siç e quajnë aktivistët romë.

Në kontekstin e ndjenjave të përhapura anti-rome pas luftës, diskriminimi është një temë e ndjeshme dhe shumë nga përfaqësuesit e komuniteteve dhe aktivistët hezitojnë ta trajtojnë atë. Antigjipsizmi përkufizohet si një 'formë specifike e racizmit, një ideologji e bazuar në epërsinë racore, një formë dehumanizimi dhe racizmi institucional i ushqyer nga diskriminimi historik, i cili shprehet, ndër të tjera, me diskriminim, dhunë, gjuhën e urrejtjes, stigmatizimin dhe shfrytëzimin".

Simptomat e situatës së tyre janë të dukshme në shkallën e lartë të papunësisë, në nivelin e ulët të përfshirjes në arsim dhe në kushtet e rënda të jetesës së shumicës së tyre.



²https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41362&fbclid=IwAR3dQ-Pqx4SldU1pxbW_AQ%C3%8Bb7odONQTKGufry4u-7Dqp7C_SbuU38bUuC7k

³ www.raportodiskriminimi.org

⁴ [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2022/730304/IPOL_STU\(2022\)730304_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2022/730304/IPOL_STU(2022)730304_EN.pdf)

1.1 Konteksti historik e social i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë

Për të ofruar një përmbledhje më të plotë të situatës së komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, në këtë sesion do të ofrohet një tablo e shkurtër e kontekstit historik e social të këtyre komuniteteve. Kushtetuta e Kosovës i njeh gjashtë komunitetet më të mëdha në Kosovë, në mesin e tyre edhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët. Ata kanë tradita, kultura e tipare të ndryshme. Kanë emra të ndryshëm dhe janë etni të ndryshme, prandaj duhet shmangur përdorimi i shkurtesës "RAE", që përdoret shpesh për t'i përshkruar të tri komunitetet jo shumicë: romët, ashkalitë dhe egjiptianët. Ky është term që përdoret gabimisht edhe në media, rrjedhimisht duhet shmangur, ngase shpesh cilësohet si ofendues nga këto tri komunitete.

Në parim, ky term është përdorur për të shmangur fjalinë e gjatë për të tri komunitetet, por është gabim që të përdoret si referencë e vetme (p.sh përdorimi i akronimit SHST për shqiptarët, serbët e turqit).

Kjo shkurtesë nuk është në Kushtetutën e Kosovës e as në dokumente zyrtare, por është e përhapur në diskursin publik, përfshirë edhe atë të zyrtarëve.

Ato janë tri komunitete të njohura dhe të ndara me Kushtetutën e Kosovës.

Termi 'rom', i cili rrjedh nga fjala në gjuhën rome për njeriun ose personin, është emërtimi tradicional për grupe të ndryshme, shumë prej të cilave flasin gjuhën rome, përfshirë romët, sinti, endacakët, manush, jenische, kalkaresh, kalé dhe grupe të tjera. Prandaj, termi nuk i referohet një komuniteti homogjen dhe jo të gjitha grupet e përfshira në term e njohin veten si romë.

Romët janë pakica më e madhe etnike në Evropë (10-12 milionë) dhe shpesh quhen me emra nënçmues, si p.sh "Ciganë"

Origjina dhe përkatësia indiane e romëve është më e dukshme nga ana gjuhësore, nga gjuha që flitet ende nga shumë anëtarë të kësaj etnie heterogjene. Romët përbëhen nga grupe të ndryshme, të cilat janë etiketuar me emra të ndryshëm: arlije, calé, gurbet, kaale, kalderaš, lovara, manuš, sepe idessinti, ursari, etj.; shumë grupe përdorin gjithashtu vetë-përcaktimin "rom". Zakonisht të gjitha këto grupe përmbliidhen, ndonjëherë edhe së bashku me grupet e popullsisë me origjinë joindiane, me emërtimin poshtërues "ciganët", i cili për arsye përshkruese dhe pa konotacione negative, ndonjëherë përdoret edhe në dokumente.

Termi 'rom', siç përdoret ndërkombëtarisht, nënkupton të gjitha grupet që ndajnë një origjinë të përbashkët indiane (romët, sinti, kale), dhe komunitetet që i referohen vetes si romë, që gjenden kryesisht në Ballkan dhe Evropën Qendrore dhe Lindore, por gjithashtu në gjithë botën". Ata janë nga një popullsi e vetme që u largua nga India rreth 1500 vjet më parë dhe u shpërnda në të gjithë Evropën.

Në këtë pjesë në do të paraqesim diversitetin rom, duke prekur gjuhën dhe dialektin, zakonet dhe profesionet tradicionale, duke ofruar disa shembuj se si rrethanat e ndryshme sociale, ekonomike dhe politike mund të kenë ndikuar ndryshe mbi komunitetet rome në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore, një ilustrim i një cikli të përjashtimit të romëve, përmes thjerrëzës së gazetarisë.

Megjithatë, këto grupe kanë histori dhe përvoja të përbashkëta të racizmit, diskriminimit dhe përjashtimit nga shoqëria.

Për këtë arsye, strukturat shoqërore diskriminuese dhe praktikat e dhunshme që dalin në këtë sfond, kanë një efekt degradues dhe përjashtues dhe që riprodhojnë disavantazhe strukturore.

Shembuj:

Bajram Kinolli rrëfen historinë e përjetimit të racizmit

<https://oralhistorykosovo.org/sq/bajram-kafu-kinolli/>

<https://www.facebook.com/OralHistoryKosovo/posts/1750386748562308>

1.2 Mediat dhe përgjegjësia

Mediat luajnë një rol kyç në zhvillimin e jetës demokratike të një vendi, duke raportuar shkeljet e të drejtave të njeriut kudo që ato ndodhin, dhe duke promovuar respektimin e të drejtave të njeriut, sidomos ndaj pakicave etnike.

Raportimi i mediave përbën një prej fuqive më të mëdha për të ndikuar në paraqitjen dhe interpretimin e realitetit, duke bartur gjithashtu një përgjegjësi të madhe për shkak të ndikimit politik, social dhe kulturor që mund të ketë ky raportim.

Si në shumë elemente tjera edhe në raport me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian mediat kanë përgjegjësi që të përmbahen nga publikimi i mesazheve diskriminuese që cenojnë të drejtat dhe lirinë e qytetarëve. Për këtë arsye, parimet etike në industrinë e mediave nuk kanë të bëjnë vetëm me kodet formale të sjelljes, por edhe me ndërgjegjësimin për pasojat e informacionit paragjykses ose stereotipet e antigjipsizmit.

Lajmet për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ndonjëherë mund të rrënohen nga thjeshtësime të tepërta, portretizime stereotipe ose gjuha e papërshtatshme. Portretizimi negativ i romëve në media është i përhapur në gjithë Ballkanin. Për këtë arsye mediat duhet të kenë kujdes në raportim ngase shpesh një sjelljeje e një individi mund të kontribuojë lehtësisht në ndërtimin e një pasqyrimi negativ shoqëror që ndikon në imazhin kolektiv të një komuniteti. Informacionet stereotipe për romët mund të ndikojnë në mënyrën se si gazetarët ndërtojnë stori të tyre, duke përhapur kështu imazhin e keq për një pakicë etnike.

Shembuj: Raportimi i Radios Evropa e Lirë për gazetarët afganë

Një rast tërhoqi vëmendje të veçantë publike ishte kur deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në përgjimet që rrodhën në publik në vitin 2011 përmenden terma fyes të politikanëve. Kujtim Paçaku kërkoi të ketë kërkim-falje në Kuvend.

Në një tjetër rast, në Kuvend, deputja e LDK-së, Valentina Bunjaku e quan “magjup” deputetin “e VV, Adnan Rustemi.

<https://ekonomiaonline.com/pergjimet-grabovci-e-quan-flora-brovinen-idiot-audio/>

<https://www.youtube.com/watch?v=XzVkJLb0pI0>

⁵ <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-3-on-combating-racism-and-intole/16808b5a29>

⁶ <https://www.hsph.harvard.edu/wp-content/uploads/sites/2464/2020/01/FXB-Kosovo-Report-July-2014.pdf>

1.3 Mediat sociale dhe rrjedhja e racizmit

Interneti është aktualisht terreni më pjellor për llojin më të rrezikshëm të racizmit. Gjuha e urrejtjes dhe antigjipsizimi, sidomos në mediat sociale dhe kudo në internet ndez paragjykime dhe dhunë. Stereotipet të tilla si: "Ata janë shumë rezistues ndaj ndryshimeve" kanë shtuar dozën e përcmimit.

Këto paragjykime disa njerëz i kanë shpesh edhe kur ka prova për të kundërtën. Për këtë arsye gazetarët dhe mediat duhet t'i denoncojnë rastet e praktikave raciste dhe diskriminuese. Duke zbatuar me ndërgjegje lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave, gazetarët kanë për detyrë ta luftojnë çdo shkëndijë anitgjipsizmi.

Lajmet e rreme dhe dekontekstualizimi i imazheve dhe videove janë një mjet i popullarizuar për të përhapur narrativat antigjipsiste dhe për të nxitur armiqësi kundër pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali apo egjiptian. Shumica e këtyre lajmeve të rreme janë ndërtuar rreth përfitimeve të supozuara për ato komunitete.

Stereotipet anti gjipsiste shfaqen në media në formën e kategorive sociale dhe etiketimeve negative si: nomadë, lypës, hajdutë, shfrytëzues të fëmijëve, etj.

Shembuj:

1. Një grua rrahët në rrugë pasi dikush publikoi se ajo sulmoi fëmijët. Ajo u rrah brutalisht nga grupe të rinjsh pasi ishte linçuar publikisht kinse vjedh fëmijë.

https://www.facebook.com/KMSHKosove/posts/2289083174467955/?locale=pt_PT

2: Screenshot: *Komentet raciste në një kronikë të Radios Evropa e Lirë pas një raportimi për gazetarët afganë në Kosovë.*

Materiale në Tik-tok

3. Gjuha raciste dhe tallja me festën e Shën Gjergjit nga një grup i komunitetit rom në Fushë-Kosovë - video

<https://www.youtube.com/watch?v=FduKQGTvFs>

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe Këshilli i Mediave të Shkruara gjithashtu në vazhdimësi kanë evidentuar rastet e shkeljeve dhe kanë kërkuar një "solidaritet kundër urrejtjes dhe dhunës në internet".

Keqraportimi apo raportimi paragjykues përbën një pjesë të madhe të atmosferës në rritje të jotolerancës që romët përjetojnë sot në Kosovë. Portretizimi stereotip i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mund të zbutet sidomos nga raportimi profesional i mediave.

Media duhet të shmangë raportimet për rastet që mund të bëhen subjekt i shtrembërimit dhe manipulimit emocional. Prandaj, është thelbësore që media të promovojë të gjitha aktivitetet që mund të parandalojnë diskriminimin, jotolerancën, urrejtjen ose mesazhet e dhunshme kundër romëve.

1.4 Trajtimi i antigjipsizmit në media

Deri më tani nuk ka statistika të plota për numrin e rasteve të antigjipsizmit në media. Por raportet e tjera, sidomos Policisë, tregojnë për një shkallë në rritje të incidenteve dhe sulmeve ndaj pjesëtarëve të komuniteteve ashkali, rom e egjiptian.

Segregacioni, sidomos në shkollat publike ku ka ndodhur që fëmijët romë apo egjiptian janë ndarë në klasa të veçanta, nuk ka qenë një rast i izoluar. Këto raste kanë marrë fare pak vëmendjen e mediave për të ngritur çështjen e pabarazisë në raste të tilla që kontribuojnë direkt në thellimin e ndarjeve mes komuniteteve në Kosovë.

Përtej kësaj, mediat kanë një fushë pak të eksploruar të ballafaqimit me përjashtimin shoqëror të romëve, ashkalive apo egjiptianëve, një problem deri diku i njëjtë në të gjitha vendet e Evropës. Përjashtimi manifestohet në formë të mospranimit, jetës në varfëri, segregacionit, qasjes së vështirësuar në shërbime sociale apo diskriminimit.

Shembuj:

Rasti i fëmijëve në Pejë në rastin e Festës së Abetares.

Në qershor të vitit 2022, gjatë shënimit të Festës së Abetares, kamerat dhe fotografitë kapin fëmijët egjiptianë që janë lënë jashtë platformës së festimit. Ata kanë mbetur në pjesën e publikut në sallë të sporteve dhe nga atje shihet që festojnë katër fëmijë të vetmuar. Për më keq në vend se të kërkohet falje dhe të ndërmerren masa ndaj këtij veprimi përbuzës drejtorja e shkollës vazhdon të mohojë veprimet diskriminuese.

https://www.youtube.com/watch?v=h0ZqY_cu4LA

<https://klankosova.tv/nagavci-per-festen-e-abetares-ku-u-lane-anash-femijet-nga-pakicat-rastin-do-ta-shqyrtojme-me-prioritet-qe-neser/>

Segregacioni në shkollën fillore “Mustafa Bakija” në Gjakovë

Në vitin 2013 në shkollën fillore “Mustafa Bakija”, në Gjakovë ishte ndarë një klasë me vetëm fëmijë romë. Pas interesimit të gazetarëve, fillimisht drejtoresha tenton ta mban fshehur e pastaj të mos lejojë qasjen në klasë, derisa Departamenti i Arsimit i Komunës mundëson hyrjen dhe verifikimin e segregacionit. Drejtoresha arsyetohet se prindërit po kërkojnë ndarje. Pas raportimit në media klasa përzihet.

Shembuj të adresimit të segregacionit: Shkolla “Mustafa Bakija” paditet në gjykatë dhe paditësit (8 prindër) fitojnë rastin në gjykatë.

<https://www.youtube.com/watch?v=NuShuFmP80U>

Përmbledhje:

Në një kohë kur interneti është një terreni pjellor për përhapjen e gjuhës së urrejtjes, racizmit dhe antigjipsizimit, gazetarët dhe mediat duhet të përdorin raportimin profesional që lufton ndarjet, paragjykimet dhe nxitjen e urrejtjes ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Raportimi i bazuar në fakte dhe pa paragjykime etnike denoncon dhe zvogëlon praktikrat raciste dhe diskriminuese. Propaganda dhe lajmet e rreme luftohen vetëm me të vërtetën.

Njohja me identitetin, kulturën dhe kontekstin historik të komuniteteve dhe aplikimi i standardeve profesionale e etike ndihmon gazetarët të ndërtojnë një tablo reale për komunitetet e marginalizuara.

SESIONI II

Tabela 2.

Sesioni 2/Temat	Kohëzgjatja	Metodologjia
2. Roli i medias kundër gjuhës së urrejtjes dhe paragjyqimeve		
2.1 Urrejtja e heshtur	30 min	Pjesa e ligjërimit apo pjesa teorike do të përqendrohet në shpjegimin e rrënjëve të diskriminimit ndaj grupeve shoqërore, të identifikuara nën stigmën 'magjup' që kanë një efekt degradues dhe izolues.
2.2 Kur intervistoni një rom, ashkali apo egjiptian	30 min	Pjesa teorike dhe detyrat praktike do të përfshijnë mënyrën se si duhet të zhvillohen instrumentet mediale për të paraqitur në mënyrën e duhur këto komunitete.
2.3 Raportimi për fëmijët - obligimet etike	30 min	Ushtrimet praktike do aplikohen për të avancuar njohuritë në teori dhe praktikë, në mënyrë që të kuptohen më mirë standardet adekuate etike në raportimin rreth komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, sidomos fëmijëve.
Shembuj Ushtrime	60 min	

1. Objektivat:

- Ofrimi i njohurive teorike dhe praktike mbi rolin e mediave kundër gjuhës së urrejtjes, përçmimit dhe paragjyqimeve ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Prezantimi i elementeve qenësore të raportimit që eliminojnë stereotipet negative ndaj pakicave etnike të cilat ushqejnë një klimë diskriminimi;
- Njohuri për elementet e veçanta që gazetarët dhe mediat duhet t'i kenë parasysh kur raportojnë për çështje që ndërlidhen me diskriminimin racor dhe forma të tjera që privojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, sidomos në rastet kur ndërlidhen me fëmijët.

Rezultatet e pritura:

Njohuri për gazetarët rreth raportimit për veprime abuzive individuale që nuk duhet t'i atribuohet një grupi të tërë. Njohuri se si raportimet për çështje të caktuara të mos krijojnë një diskurs stigmatizues për komunitetin. Çfarë duhet të kenë parasysh gazetarët kur gjatë intervistimit kanë të bëjnë me persona të rritur apo fëmijë të komunitetit rom, ashkali apo egjiptian. Njohuri dhe udhëzime se kur duhet të jepen detaje rreth origjinës etnike të atyre që janë të përfshirë në një situatë të caktuar.

2. Roli i medias kundër gjuhës së urrejtjes dhe paragjyqimeve

Mediat kanë përgjegjësi të madhe dhe interes për të ruajtur besueshmërinë e tyre, që garantohet përmes një raportimi të drejtë dhe saktë, dhe gazetaria e mirë e bazuar në kodin etik për raportimin e lajmeve që përfshijnë romët mund të ndryshojë dhe përmirësojë perceptimin publik për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian.

Stereotipet negative për romët janë aq të përhapur sa që kanë ndikim në çdo sferë të jetës së tyre, duke ushqyer një klimë të gjerë diskriminimi.

Mediat, ndonjëherë në mënyrë të pandërgjegjshme përhapin ndjenja antigjipsizmi.

Lajmet shpesh përfshijnë informacione të panevojshme që kanë një efekt negativ në grupe të marginalizuara që mund të kontribuojnë në procesin e stigmatizimit.

Për më tepër, duke pasur parasysh se faktet e përdorura nga mediat duhet të vërtetohen, ne do të vëmë në dyshim identifikimin e një personi si rom duke qenë se në shumë vende evropiane është e ndaluar të regjistrohet zyrtarisht përkatësia etnike e dikujt.

Për këtë arsye, është e vështirë të përdoret përkatësia etnike në një mënyrë të duhur dhe të bazuar në fakte.

Ka raste të ndryshme ku romët portretizohen si nomadë, si kriminelë apo problematikë dhe me raportime të tilla dhe një diskurs të përhapur stigmatizues ekziston rreziku i "rrënjësjes dhe prezantimit negativ të romëve në media".

Shembuj të këtij lloji të raportimit përfshijnë reagimet jo proporcionale të urrejtjes në media ndaj romëve.

Pas një vrasjeje që përfshiu një rom, mbulimi mediatik tregoi fuqinë dhe ndikimin e medias, duke formuar një aleancë të fortë që përfshinte deklarata raciste në diskursin publik, e cila kontribuoi në një rritje të urrejtjes.¹⁰

⁷<https://www.media-diversity.org/scarcely-debated-rarely-remembered-the-medias-lack-of-roma-representation-could-lead-to-hate-speech/>

⁸<https://crd.org/wp-content/uploads/2018/02/The-Wall-of-Anti-Gypsyism-%E2%80%93-Roma-in-Kosovo-Alb.pdf>

Gazetarët duhet të kenë parasysh gjithashtu se vendosja e lajmit që i referohet origjinës rome apo të tjerëve ka ndikim, ashtu si nënvizimi në tituj, apo përfshirja e një fotoje të vendbanimeve rome.

Nëse artikulli shfaqet në faqen e parë të një gazete ose titujt kryesorë të lajmeve në TV, për shembull, ai do të ketë gjithashtu një ndikim shumë më të madh social.

Gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm se një sjellje individuale mund t'i atribuohet një grupi të tërë kur përkatësia etnike e një personi demonizon një komunitet të tërë, pa ofruar ndonjë vlerë të shtuar për të kuptuarit e lajmit.

Shembuj:

1: TV Podujeva bën një publikim për një rom nga komuna e Podujevës që së pari është përmendur në media se është arrestuar për krime lufte për bashkëpunim me forcat serbe. Më vonë i njëjti ka vdekur pasi është sulmuar nga një person pak ditë më vonë në Prishtinë.

Theksimi i grupit etnik gjatë raportimit për një krim apo ndonjë fenomen, apo përmendja e përkatësisë etnike të kryesit nuk i shërben ndonjë qëllimi konstruktiv.

Në disa situata, mund të jepen argumente në favor të përmendjes së origjinës etnike të atyre që janë të përfshirë në një situatë të caktuar, por këto do të ishin përjashtim dhe në përgjithësi do të kishin shumë më pak peshë.

Në mesin e atyre që janë kundër jo specifikimit të etnisë, thjesht mund të pyetet gazetari se çfarë kriteresh ka përdorur për të identifikuar një person të caktuar si rom (sidomos duke pasur parasysh se në Kosovë nuk ka asnjë dokument identifikimi që përmban informacione të tilla).

Origjina etnike as që duhet të përmendet nga policia në raportet e saj. Përmendja e përkatësisë etnike, veçanërisht kur rrëfen ngjarje kriminale, ka efektin kryesor të stigmatizimit ose demonizimit të një komuniteti të tërë për krime të kryera ose ndonjë dukuri negative. Komunikatat e policisë shpesh theksojnë etninë.

Nëse nuk është i regjistruar si krim i motivuar etnikisht pse duhet të theksohet etnia? Kuptohet se media mund të dëshirojë të përmendë grupin etnik kur raporton akte dhune ose të ngjashme. Por këto raste duhet të jenë një përjashtim dhe jo rregull.

Shembuj:

“Një mashkull rom është arrestuar pasi ka therur me thikë bashkëshorten”.

“Një burrë rom u kap me njëthikë duke vjedhur Postën e Kosovës”

2.1 Urrejtja e heshtur

Rrallë të debatuar dhe të përmendur. Mungesa e përfaqësimit të romëve në media kontribuon në marginalizimin e mëtejshëm të tyre dhe thëllon përjashtimin.

Romët rrallë portretizohen në media përveçse kur ndërlidhen me varfërinë ose me gjëra që kanë të bëjnë me etnitetin e tyre. Por ata nuk portretizohen për çështje tjera.

Media romë gjithashtu e portretizon fare pak identitetin dhe ekzistencën romë në shoqëri.

Zakonisht diskriminimi i drejtpërdrejtë: lidhet kur një person apo një grup trajtohet në një mënyrë më pak të favorshme se një tjetër për shkak të origjinës etnike.

Por diskriminimi indirekt është një qëndrim, kriter ose praktikë në dukje neutrale që i vë në disavantazh personat me origjinë të caktuar racore ose etnike.

Duke i injoruar, shmangur apo duke i anashkaluar raportimet më të gjera për pakicat etnike, përveçse në kontekst negativ, mediat dhe gazetarët direkt apo indirekt reflektojnë atë që konsiderohet si “urrejtje e heshtur” ndaj një grupi të caktuar etnik.

Për të shfaqur urrejtjen e heshtur, mediat mjaftojnë të shmangin raportimet për grupe të caktuara etnike duke i lënë ato plotësisht nën hije dhe pa platformën e duhur për të paraqitur kulturën, identitetin e tyre apo brengat dhe problemet e tyre brenda një shoqërie ku ata jetojnë.

Mediat ende kanë pak interes për temat që lidhen me minoritetet dhe pavarësisht se pakicat janë pjesë e lajmeve në vend, ato nuk janë aq shumë pjesë e programeve origjinale që paraqesin diversitet në mënyrë të detajuar.

Raportimet më shumë kanë tituj sensacional ose të bujshëm apo diskriminues për të tërhequr vëmendjen e lexuesit apo shikuesit.

2.2 Intervistimi i personave apo grupeve të marginalizuara

Kur intervistoni një person të komuniteteve rom, ashkali apo egjiptian, duhet të jeni të vetëdijshëm që nuk duhet të përdorni termat “gabel”, “arixhi”, “gjipsi” apo “magjup”!

Mos bëni sjellje apo mimika nënçmuese!

Duhet të siguroheni që personi që intervistoni është i vetëdijshëm për pasojat e intervistës. Nëse jo, kujdesuni që të mos përdorni gjëra që mund t'i dëmtojnë ata.

Trajtoni, romët, ashkallitë apo egjiptianët siç do të trajtonit çdo grup tjetër shoqëror!

Mos provoni të paraqisni një imazh idilik, paternalist dhe rrjedhimisht të rremë për romët, egjiptianët dhe ashkallitë, sepse pasojat janë edhe më të këqija.

Para çdo interviste, shpjegoni qëllimin e intervistës dhe hulumtimit e përgjithshëm, llojin e çështjeve që trajtohen dhe mënyrën se si do të përdoret intervista?

Individëve duhet shpesh t'u thuhet se mund të mos përgjigjen në ndonjë pyetje, të bënin një pushim ose të përfundonin intervistën në çdo kohë.

Nëse tema nuk ndërlidhet me etninë, nuk duhet të bëni pyetje rreth racës/etnisë apo ngjyrës, nuk është e përshtatshme në një intervistë.

Të intervistuarit nuk duhet t'u jepet asnjë kompensim material ose shërbim tjetër për intervistën.

Shmangni pyetjet për origjinën kombëtare apo prejardhjen.

Nëse nuk është e domosdoshme shmangni pyetjet për shëndetin fizik apo mental.

⁹ <https://rm.coe.int/adi-rom-2020-27-final-antigypsyism-causes-prevalence-consequences-poss/1680a6d053>

¹⁰ https://www.gitanos.org/upload/12/19/guia_ingles.pdf

2.3 Raportimi për fëmijët; obligimet etike

Gazetarët dhe mediat duhet të përpiqen të ruajnë standardet më të larta të sjelljes etike në raportimin e çështjeve të fëmijëve.

Një nga parimet kryesore etike është të mos publikohet kurrë një histori, fotografi ose video që ekspozon një fëmijë, vëllezërit e motrat ose bashkëmoshatarët e tij/saj në rrezik, edhe kur identiteti i fëmijës ndryshohet, mjegullohet ose nuk publikohet. Gjithashtu, leja e prindit dhe kujdestarit të tij duhet të merret gjithmonë për të gjitha intervistat, regjistrimet video dhe fotografitë.

Media duhet të ndryshojë gjithmonë emrin dhe të turbullojë imazhin e çdo fëmije që konstatohet se është: viktimë e abuzimit ose shfrytëzimit seksual, autor i abuzimit fizik ose seksual, i akuzuar ose i dënuar për një krim, përveç nëse fëmija dhe kujdestari japin pëlqimin e tyre me vetëdije të plotë.

Intervistat duhet të zhvillohen vetëm në kushte kur fëmijët janë të sigurt, si nga rreziku i shfrytëzimit të mëtejshëm ashtu edhe nga hakmarrja. Gazetarët mund të bashkëpunojnë me një OJQ e cila është e besuar nga fëmijët dhe ka të dhëna mbështetëse. Gazetarët nuk duhet të bëjnë kurrë intervista të tilla vetëm dhe duhet të marrin masa të veçanta për t'u siguruar që fëmijët të mos ndihen nën presion ose 'klientë' të medias.

Intervistuesi duhet të ulet ose të qëndrojë në të njëjtën lartësi me fëmijën dhe të mos "flasë nga lart", qoftë edhe në mënyrë metaforike.

Pyetjet duhet t'i drejtohen fëmijës, jo të rriturit, dhe intervistuesi duhet të ketë zë të qetë, miqësor dhe neutral si dhe të mos reagojë me habi.

1. Kur raportoni për çështjet e fëmijëve, përpiquni t'u përmbaheni standardeve në aspektin e saktësisë dhe ndjeshmërisë;
 2. Shmangni publikimin e imazheve që ndërhyjnë në privatësinë fëmijëve me informacione të dëmshme për ta;
 3. Bëni prezantime jo sensacionale për të promovuar materiale gazetareske ku përfshihen fëmijët;
 4. Për të minimizuar dëmin ndaj tyre, analizoni me kujdes pasojat e publikimit të çdo materiali në lidhje me fëmijët;
 5. Largoni fëmijët nga identifikimi vizual, përveç rasteve kur kjo është dukshëm në interesin publik, sidomos shmangni ata që kërkojnë lëmoshë ose pastrojnë xhama veturash;
 6. Siguroni verifikim të pavarur të informacionit të dhënë për fëmijët, pa vënë në rrezik informatorët e fëmijëve;
 7. Shmangni përdorimin e imazheve provokative të fëmijëve;
 8. Përdorni metoda të hapura dhe të drejtpërdrejta për marrjen e fotografive dhe, kur është e mundur, me dijeninë dhe pëlqimin e fëmijëve ose të një të rrituri, kujdestari ose përgjegjës ligjor;
 9. Verifikoni kredencialet e çdo organizate që flet për përfaqëson interesat e fëmijëve;
 10. Mos paguani fëmijët për materiale që kanë të bëjnë me mirëqenien e fëmijëve;
- Mbroni fëmijët, dhe gjithçka që mund të ndikojë në stigmatizimin apo bullizimin ndaj tyre.

Shembuj:

S 1. Kronika e RTK 1 - Plemetin

Një në kronikë televizive të RTK gazetari shihet vazhdimisht duke qeshur në mënyrë tallëse me disa nga romët që flasin në kronikë. Në fund para kamerës i kërkon një fëmije rom të këndojë në gjuhën serbe.

2. Kronika e RTK2 – Graçanicë

Në kronikën e RTK2 në gjuhën serbe gazetarja në mesin e disa pyetjeve të tjera që nuk ndërlidhen me fëmijë e pyet fëmijën 6-7 nëse baba e tradhton nënën e tij ndonjëherë?

Ushtrime praktike: Ndërtimi i një raporti që ndërlidhet me elementet e përfshira në modul.



Përmbledhje:

Gazetarët dhe mediat kanë përgjegjësi të raportojnë drejt dhe saktë, një gjë që ndikon direkt në ndryshimin e perceptimit paragjykses për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian.

Për t'iu kundërvënë stereotipeve negative, gazetarët duhet të mos i referohen origjinës rome, ashkali apo egjiptian kur bëhet fjalë për raste që ndërlidhen me krimet ordinere apo krime të tjera.

Gjatë intervistimit të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve gazetarët nuk duhet të përdorin termat përçmues për këto komunitete dhe duhet t'i trajtojnë ata në mënyrë të dinjitetshme, duke mos paraqitur gjithashtu një imazh paternalist apo jo real. Gazetarët duhet të ruajnë standardet etike në raportimin e çështjeve të fëmijëve, duke mos publikuar pamje apo identitetin e fëmijëve kur bëhet fjalë për abuzim dhe pa lejen e personave përgjegjës kur bëhet fjalë për çështje të tjera.

SESIONI III

Tabela 3.

Sesioni 3/Temat	Kohëzgjatja	Metodologjia
Lufta ndaj marginalizimit dhe përjashtimit social		
3.1 Pesha e gjuhës së përdorur		Në pjesën teorike, analiza e storieve dhe simulimi do të përdoren për të kuptuar peshën e gjuhës që përdoret në raportim dhe komunikim.
3.2 Raportimi që shmang stereotipet		Përmes njohurive teorike dhe shembujve praktikë do të shpjegohet se antigjipsizmi nuk ka të bëjë vetëm me atë që thuhet dhe bëhet, por edhe me atë që nuk bëhet.
3.3 Portretizimi i në media i romëve, ashkalive edhe egjiptianëve - raportimi mbi varfërinë		Duke paraqitur shembuj, teorik e praktik, se si varfëria ndikon në perceptimin e tyre, do të përfshihen metoda mësimore që ndihmojnë në zvogëlimin e hendekut të pabarazisë.
Pyetje/ushtrime praktike		Pyetjet, diskutimet, dhe format tjera interaktive do të aplikohen si teknika mësimore për të thelluar të kuptuarit e gazetarëve për çështjen e antigjipsizmit në mënyrë që të krijojnë dhe formojnë hipoteza që sfidojnë pikëpamje të tjera.

1. Objektivat:

- Ofrimi i njohurive dhe praktikave të raportimit se si mediat mund të ndikojnë zvogëlimin e marginalizimit dhe përjashtimit social të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe si ato mund të ndikojnë në krijimin e një klime më të mirë të paraqitjes së tyre në media;
- Elaborim të detajuar për peshën e gjuhës së përdorur në media dhe efekti i saj në opinionin publik që ndikon në jetën e këtyre komuniteteve;
- Pasqyrim i modeleve profesionale që mund të përdoren për të shmangur stereotipet e rrënjosura ndaj këtyre komuniteteve duke ndikuar në pozitën e tyre të përgjithshme në shoqëri, e sidomos efektet e portretizimit më të shpeshtë të tyre si komunitet i zhytur në varfëri.

Rezultatet e pritura:

Njohuri më të mëdha se si mediat ndikojnë në integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në jetën shoqërore të një vendi. Njohuri mbi faktorët diskriminues strukturorë dhe historikë që mund të zvogëlohen me një mbulim më të mirë në media, sidomos luftimin e asaj që perceptohet si superioritet ndaj tyre, si dhe përdorimi i elementeve që përfshin mekanizmat shtetëror për të adresuar diskriminimin, racizmin dhe ndarjen.

3. Lufta ndaj marginalizimit dhe përjashtimit social

Fenomeni i vazhdueshëm i përjashtimit social vazhdon të jetë një hendek i madh në Kosovë dhe kudo në Ballkan. Komuniteti rom, ndonëse konsiderohet si një grup etnik, nuk gëzon të gjitha të drejtat që i përkasin. Pjesëmarrja efektive e pakicës romë, ashkali dhe egjiptianë në jetën publike, si një element qenësor në shoqëritë demokratike, është ende e dobët.

Në këtë mënyrë rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik në lidhje me stereotipet, paragjykimet dhe antigjipsizmin, në përgjithësi duhet bërë, duke identifikuar dhe raportuar forma të tilla diskriminuese.

Paragjykimi dhe përjashtimi i romëve dhe të tjerëve nga shoqëria bazohen në faktorë strukturorë dhe historikë që mund të zbutet me një mbulim më të mirë në media. Ndër to është një hierarki epërsie dhe inferioriteti në sjelljen dhe perceptimin njerëzor që ka ekzistuar për shekuj me radhë, që janë prodhuar dhe riprodhuar politikisht, kulturalisht dhe ekonomikisht dhe kjo praktikë ndaj romëve vazhdon të jetojë në sjelljen e shumë njerëzve.

Strategjia e qeverisë së Kosovës për periudhën 2022-2026 është e bazuar në premisat e njëjta të strategjive të mëhershme që thekson nevojat primare të këtyre komuniteteve: arsimin, punësimin, shëndetin, banimin dhe luftën ndaj diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, ndarjes dhe paragjyqimeve.

Kjo është një fushë ku mediat mund të kërkojnë më shumë informacion për sfidat dhe dështimet e autoriteteve në avancimin e pozitës shoqërore të këtyre pakicave etnike.

Shembujt:

Fëmijëve romë nuk u lejohet të futen në këndin e lojërave - video

<https://www.youtube.com/watch?v=saRTYj19yC8>

¹¹ <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/X2H-Xref-ViewHTML.asp?FileID=9676&lang=EN>

¹² <https://rm.coe.int/adi-rom-2020-27-final-antigypsyism-causes-prevalence-consequences-poss/1680a6d053>

¹³ https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41362&fbclid=IwAR3dQ-Pqx4SIU1pxbW_AQWb7odONQTKGufry4u-7Dqp7C_SbuU38bUuC7k

3.1 Peshë e gjuhës së përdorur

Përdorimi i termit “gabel” apo “magjup” si gjatë referimit të këtyre komuniteteve apo si krahasim apo nënçmim i dikujt, si dhe pranimi apo mos luftimi i shprehjeve të tilla përcmuese ndaj romëve, ashkalive, egjiptianëve janë një fushë ku mediat kanë ndikim të fuqishëm në eliminimin e tyre.

“Humori” si etiketim apo tallje gjithashtu nuk mund të përdoret si justifikim për fyerje apo shpifje. Një shembull humori ofendues:

https://www.tiktok.com/@agji_driton/video/7239601628016348443?_r=1&_t=8co45BnUt8w

Gjuha e përditshme e përcmimit e tipit: jeni bërë si “magjup”

Luftimi i termave pezhorativë apo përcmues nevojitet jo vetëm në raportim por edhe gjatë komunikimit me këto komunitete dhe me të tjerët. Kudo që gazetaret mundën duhet t'i kundërvihen diskursit përcmues apo termave të papërshtatshëm dhe stigmatizues si: magjupë, gabelë, çergash apo të zi...

Shembuj : Redaktorja përgjegjëse në mediumin publik i thotë gazetares: “Ke bërë emër me morra të magjupve”.

Termet përcmues në serialin “Çka ka shpija” në RTK.

3.2 Raportimi që shmang stereotipet

Stereotipet atribuojnë karakteristika të caktuara një grupi të caktuar me synimin për të përgjithësuar pamjen, sjelljen, zakonet e tyre, etj.

Për të shmangur gjuhën raciste apo stereotipet, mediat duhet të shfaqin më shumë elemente pozitive për komunitetet rom, shkali dhe egjiptian, për dhënë një tablo më inkurajuese dhe për të paraqitur një portretizim më të balancuar të këtyre komuniteteve.

- Gazetarët duhet të ndërveprojnë më shumë me përfaqësuesit e këtyre komuniteteve për të dëgjuar më shumë për shqetësimet e tyre dhe përfaqësimin e tyre në media.
- Komunikimi do t'i ndihmojë gazetarët për të pasur më shumë ide profesionale për të prodhuar informacion të paanshëm dhe shmangur diskriminimin dhe paragjykimin ndaj romëve.
- Mediat duhet të përdorin terminologjinë e duhur e cila është në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar, në mënyrë që t'i ofrojnë opinionit raportim të saktë.
- Përveç njohurive bazë dhe kodit etik, gazetarët duhet të njihen me legjislacionin kundër diskriminimit.
- Vendosni gjithmonë faktet në kontekst.
- Paraqisni njerëzit si qenie njerëzore në vend të pjesëtarëve të grupeve etnike.
- Mbron identitetin dhe imazhin e viktimave të dhunës seksuale apo trafikimit që pranojnë të flasin në kushte anonimiteti.
- Merrni parasysh pasojat e informacionit që nxit diskriminimin.
- Mediat duhet të kenë kujdes ndaj personave të cilët mund të mos jenë të vetëdijshëm për peshën e medias dhe mund të parashikojnë pasojat e vendimit për t'u shfaqur në media.

- Mediat nuk duhet t'u japin hapësirë pa kundërpërgjigje fjalimeve të figurave politike që nxisin ndarje apo ksenofobi.
- Përdorimi i imazheve si shitësit ambulante apo lypsarët përforcojnë stereotipet.
- Konsultoni njohësit e një fushe të caktuar apo organizata me ekspertizë specifike në këtë temë, për t'i ofruar publikut informacionin e duhur.

Shmangni:

- Përdorimin e gjuhës përçmuese.
- Shkurtesat në vend informacionit korrekt.
- Përdorimin e klisheve e stereotipeve negative.
- Përdorimin arbitrar të imazheve.

Edukimi medial, artet, kultura dhe analiza historike për këto komunitete kanë një ndikim të qëndrueshëm në forcimin e vlerave demokratike dhe sistemit shoqëror që promovon bashkëjetesën.

3.3 Portretizimi i në media i romëve, ashkalive edhe egjiptianëve - raportimi mbi varfërinë

Një numër i konsiderueshëm i familjeve dhe fëmijëve nga radhët e komuniteteve rom, shkali dhe egjiptian për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike detyrohen të gjejnë alternativa të tjera për të siguruar jetesën.

Shumë prej fëmijëve të këtyre komuniteteve gjenden në situatë rruge, duke kryer punë të ndryshme, si kërkim lëmoshe, pastrimin e xhamave të veturave, mbledhjen e kanaqeve.

Mediat shpesh paraqesin këta fëmijë, duke shfaqur fytyrat dhe identitetin e tyre dhe duke i intervistuar pa lejen e prindërve ose një personi përgjegjës. Raportimi për varfërinë është i pashmangshëm por nuk duhet të ekspozohet vetëm mjerimi i tyre.

Shembuj:

Kronikat e Radio Kosovës

– Gazetarja gjatë një rrëfimi për bashkëjetesën e komuniteteve thotë: kolegu im “gabel”, duke iu referuar gazetarit të redaksisë rome

Ushtrime praktike – Përgatitja e një raporti që shmang stereotipet

Përmbledhje:

Përmes një raportimi profesional dhe jo paragjykues mediat ndikojnë direkt në rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik në lidhje me stereotipet, paragjykimet dhe antigjipsizmin, në përgjithësi.

Duke u fokusuar në raportimet mbi arsimin, punësimin, shëndetin, banimin dhe luftën ndaj diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe paragjytimeve mediat mund të kërkojnë më shumë informacion dhe llogaridhënie nga autoritetet për pozitën e këtyre grupeve të marginalizuara.

Mediat mund të portretizojnë më mirë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian jo vetëm nëse shmangin stereotipet por edhe duke shfaqur më shumë elemente pozitive për ata.

Duke identifikuar dhe raportuar format diskriminuese dhe përjashtimin social e kulturor, mediat ndikojnë në zvogëlimin e hendekut të një perceptimi inferioriteti që mbetet i rrënjosur në sjelljen e shumë njerëzve, sidomos duke mos u fokusuar gjithmonë vetëm në varfërinë e skajshme të këtij komuniteti.

SESIONI IV

Tabela 4.

Sesioni 4/Temat	Kohëzgjatja	Metodologjia
Roli i rregullatorëve të mediave në luftën kundër diskriminimit		
	25 min	Në këtë pjesë do të bëhet një prezantim i shkurtër rreth rolit dhe përgjegjësi të mekanizmave rregullues medialë në luftimin e antigjipsizmit në media. Përmes diskutimit të legjislacionit dhe detyrave të rregulluesve të mediave elektronike dhe mediave të shkruara do të analizojmë rolin e këtyre institucioneve në parandalimin dhe luftimin e diskriminimit racor në mediat elektronike dhe të shkruara të Kosovës
4.1 Komunikimi parasocial	25 min	Në këtë pjesë do të shpjegohet komunikimi parasocial si një proces që krijohet mes publikut dhe një personazhi të caktuar apo një grupi njerëzish apo një komuniteti. Do të shpjegohen format dhe tiparet se si raportimi ndikon në krijimin e një perceptimi për një grup të caktuar nga distanca dhe si kjo mundëson një lloj ndërveprimi të njëanshëm, sikur se t'i kishin parë e njohur në jetën reale
4.2 Lista e verifikimit të diversitetit	25 min	Rastet studimore apo ato ilustruese do të përdoren për të shpjeguar taktikat e luftimit të diskriminimit dhe për të zhvendosur vëmendjen e mediave në tejkalimin e efekteve afatgjata të antigjipsizmit.
4.3 Raportimet solidarizuese dhe gjërat që bashkojnë	25 min	Përmes shembujve me vizuale foto, tituj, video dhe imazhe të tjera gazetarët të shohin dhe dëgjojnë siç duhet elementet e nevojshme që ndihmojnë për ta bërë procesin mësimor më efektiv.
Shembuj Ushtrime	45 min	Ushtrime, raporte, kronika , do të përdoren për të ofruar sugjerime se si mund të kontribuohet në një përtretim më të mirë të këtyre komuniteteve në media.

1. Objektivat:

- Pasqyrimi dhe analizimi i rolit të rregullatorëve të mediave karshi antigjipsizmit dhe formave tjera të diskriminimit të pakicave rom, shkali dhe egjiptian në media;
- Ofrimi i njohurive dhe rolit aktual të platformës nacionale për mbrojtje nga diskriminimi racor dhe segregimi;
- Ofrimi i njohurive dhe praktikave më të mira profesionale që mund të ndikojnë në zbutjen e pabarazisë sociale e shoqërore përmes rolit të mediave;
- Paraqitje modeleve profesionale në teorike dhe praktikë se si raportimet e paanshme dhe solidarizuese ndikojnë në portretizimin më të mirë në media të këtyre komuniteteve.

Rezultatet e pritura:

Diskutimi dhe identifikimi i përgjegjësive të mekanizmave rregullues medialë në luftimin e antigjipsizmit në media. Nivel më i mirë i të kuptuarit të rolit të gazetarëve për një mjedis medial që ofron më shumë hapësirë për grupet e marginalizuara dhe më shumë ide për të hulumtuar dhe raportuar mbi diskriminimin racor në vend, një fushë ku ata mund të ofrojnë më shumë informacion për sfidat dhe dështimet e autoriteteve në avancimin e pozitës shoqërore të këtyre pakicave etnike.

4. Roli i rregullatorëve të mediave në luftimin e diskriminimit

Kosova ka dy rregullatorë të Mediave: Komisionin e Pavarur të Mediave që rregullon shërbimet audovizuale dhe Këshillin e Mediave të Shkruara, një organ vetërregullues që trajton çështje të shkeljeve etike.

Në përgjithësi ato nuk kanë shumë rol aktiv në luftimin e Antigjipsizmit, përveç rasteve kur ka ankesa. Por nuk ka zakonisht shumë ankesa që trajtohen për rastet ku raportimet përmbajnë elemente të antigjipsizmit.

Gjithashtu është evidente se ka pasur veprime të pamjaftueshme të mekanizmave institucionalë ndaj Antigjipsizmit në media, sidomos nga Komisioni i Pavarur për Media.

Çfarë mund të bëhet kur evidentohet gjuha e urrejtjes në media?

Këshilli i Mediave të Shkruara deri më tani nuk ka trajtuar asnjë ankesë për shkelje etike të mediave të shkruara. Por megjithatë ka reaguar në vetëm një rast atë të dhunës ndaj gruas rome që u rrah brutalisht, pasi ishte paraqitur si vjedhëse e fëmijëve.

Megjithatë ndonëse nuk kanë ndonjë rol në organet rregulluese ose vetërregulluese të mediave pjesëtarët e komuniteteve rom, shkali dhe egjiptian kanë luajtur një rol të rëndësishëm në denoncimin e rasteve të diskriminimit.

4.1 Komunikimi parasocial

Komunikimi parasocial është një proces që krijohet mes publikut dhe një personazhi të caktuar apo një grupi njerëzish apo një komuniteti. Shikimi në media është një mjet më i fortë dhe më i besueshëm i qëndrimeve pozitive ndërgrupore sesa ndërveprimi i drejtpërdrejtë.

Kur mediat raportojnë më shumë dhe në një mënyrë reale, duke paraqitur shumë dimensione të jetës dhe historisë së një komuniteti kjo mundëson një lloj ndërveprimi të njëanshëm me personazhet në media apo me një grup të tërë.

Përmes mediave mund të krijohet një perceptim për njerëz, që ndjehen sikur se t'i kishin parë e njohur në jetën reale.

Shikimi ose leximi i ndërveprimeve në media të gjërave që lidhen me jetën dhe kulturën e pakicave etnike sjellin qëndrime më pozitive ndaj tyre.

Sfidimi aktiv i stereotipeve kur ato ndodhin është një mjet i rëndësishëm për të luftuar paragjykimet.

Ofrimi i hapësirës në media nuk lejon që disa paraqitje negative të formësojnë mënyrën se si njerëzit i trajtojnë apo i perceptojnë këto komunitete.

4.2 Lista e verifikimit të diversitetit

Mungesa e diversitetit nëpër redaksi po nxjerr në pah probleme dhe po shton vëmendjen e shumë mediave në vitet e fundit. Shumica e menaxherëve të mediave dinë të mbikëqyrin nga afër punësimin e gazetarëve, përzgjedhjen dhe mentorimin e storiëve. Por çfarë tjetër mund të bëhet që mediat të jenë më serioze dhe më efikase në lidhje me diversifikimin e redaksive?

Shpesh editorët dhe gazetarët nuk u kushtojnë shumë vëmendje apo nuk kanë lexuar mbi "paragjykimet e pavetëdijshme", se si ato ndikojnë edhe te njerëzit me qëllime të mira që marrin vendime për raportimin dhe mund të formësojnë mënyrën se si i kornizohen lajmet.

Çfarë burimesh kultivoni për t'u siguruar që po ofroni kontekst kulturor dhe historik, jo vetëm një pjesë "vox pop" që shton zhurmën, por nuk hedh dritë në realitetin e tyre.

- Cilat janë supozimet e mia personale për njerëzit për të cilët po raportoj?
- A jam i hapur për të pranuar ide për storie që shkojnë përtej këndvështrimit tim kulturor?
- A kam ndonjë paragjykim ndaj çështjes apo stories që po trajtoj?
- Nëse përmend ngjyrën, përkatësinë etnike ose pamjen fizike, a është e rëndësishme?
- A po përdori termat e duhura për të përshkruar njerëzit ose kulturën e tyre?
- A kam biseduar me kolegë me përvojë ose njerëz me prejardhje të ndryshme për këtë storie?
- A kam përdorur një shumëllojshmëri opinionesh dhe burimesh, duke përfshirë edhe grupet e pakicave?

14 <https://bristoluniversitypressdigital.com/display/book/9781447357520/ch003.xml>

- A ka një diskurs dominues? A e kam vënë në dyshim këtë qasje?
- A jam siguruar që puna ime të mos pasqyrojë stereotipe?
- A jam i ndjeshëm mjaftueshëm ndaj nevojave të njerëzve të përfshirë drejtpërdrejt në këtë çështje?
- A e kam analizuar ndikimin e stories apo imazhet mbi jetën e të tjerëve?

4.3 Raportimet solidarizuese dhe gjërat që bashkojnë

Është e rëndësishme që një grup që përballet me një refuzim serioz nga shoqëria, të ketë mbështetjen e medias përmes shpërndarjes së lajmeve pozitive.

Mediat duhet të kenë gjithashtu rregullore udhëzuese për të paraqitur më shumë diversitet në lajmet që raportojnë.

Raportoni për shembuj pozitivë sa herë që është e mundur në këtë mënyrë duke shmangur antigjipsizmin dhe duke mos i lidhur këto komunitete vetëm me varfërinë, përjashtimin dhe paligjshmërinë.

Bëni të dëgjohet më shumë zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.

Mediat duhet t'u japin romëve më shumë mundësi që të shprehur opinionet e tyre.

Praktikat për promovimin e tolerancës dhe mirëkuptimit zbatohen në shkollat e gazetarisë, dhe forcohen nga organizatat mediatike, duke ushtruar profesionin.

Ndiqni objektivitetin, pavarësisht se sa e vështirë është.

Krahasoni informacionin me sa më shumë burime të nevojshme.

Bëni dallime të qarta mes informacionit dhe opinionit.

Raportoni në të dyja anët e një historie ku ato ekzistojnë.

Tërhiqni informacionin e gabuar.

Në librat shkollorë ka fare pak informacion për historinë, kulturën dhe gjuhën e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Gazetarët gjithashtu shpesh nuk kanë njohuri të mjaftueshme.

Në vendet e BE-së qeveritë kanë filluar të përfshijnë referenca për romët në kurrikulën shkollore dhe disa masa për të promovuar kulturën rome në shkolla.

- Mediat e ndara rrallë bëjnë raporte pozitive për palën tjetër.
- Arritja në anën tjetër është e vetmja mënyrë që gazetarët mund të ndihmojnë për të kapërcyer barrierat e palëve kundërshtarë
- Raportoni për interesat ose qëllimet e përbashkëta

Mjetet më të fuqishme të gazetarëve dhe mediave janë fjalët që përdorin, ndjeshmëria dhe mirëkuptimi dhe këto mjete mund të përdoren për të ndërtuar mirëkuptim në vend të urrejtjes.

Eliminimi i paragjykimeve dhe antigjipsizmit vjen duke ofruar informacion të paanshëm dhe duke shpjeguar diskriminimin e shumëfishtë me të cilin përballet këto komunitete në jetën e tyre. Duke raportuar në çështje që ndikojnë në eliminimin e paragjykimeve mediat kontribuojnë në zvogëlimin e racizmit.

Shembuj:

Një piktoe e re rome, Fahrija Mehmeti, ekspozitat e së cilës janë shfaqur në Kosovë dhe disa vende të Evropës. Ajo është një shembull frymëzimi për të gjithë rinjtë që kalojnë nëpër vështirësi gjatë fëmijërisë së tyre, por sërish arrijnë që të realizojnë ëndrrat e tyre dhe shpesh më shumë se që kanë ëndërruar <https://paper.fm/portretizimi-i-kultures-rome-permes-piktures/>

Përpjekjet për të siguruar mësues dhe libra në gjuhën rome kulmuan vitin e kaluar me hapjen e një biblioteke me libra në gjuhën rome në Prizren – dhe që atëherë interesi për të është duke u rritur.

https://balkaninsight.com/2023/07/31/open-book-roma-library-offers-marginalised-community-in-kosovo-an-educational-window/?fbclid=IwAR0Kd2KQ_efx9cKJuD30UrUT--rhMGePYIirUOcd_0eJsYrvRS0BfGvVPMs

Ushtrime praktike: Ndërtimi i një raporti që ndërlidhet me elementet e përfshira në modul.

Përmbledhje:

Rregullatorët e mediave, Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Këshilli i Mediave të Shkruara, si organe vetërregulluese mund të luajnë një rol më aktiv në luftimin e antigjipsizmit, jo vetëm në rastet kur ka ankesa direkte për shkelje.

Duke hulumtuar, identifikuar dhe raportuar mbi antigjipsizmin dhe diskriminimin, mediat ndikojnë direkt në adresimin dhe luftimin e diskriminimit racor.

Raportimet që shpalosin anë pozitive dhe inkurajuese dhe u japin më shumë romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve mund të zvogëlojnë ndarjet, pabarazitë shoqërore, duke shmangur kështu antigjipsizmin.

Shkollat e gazetarisë dhe mediat duhet të aplikojnë gjithashtu praktikat për promovimin e tolerancës dhe bashkëjetesës.

Eliminimi i antigjipsizmit vjen duke ofruar informacion të paanshëm dhe duke shpjeguar diskriminimin e shumëfishtë me të cilin përballen këto komunitete.

Lista e materialeve/burimeve:

https://www.gitanos.org/upload/12/19/guia_ingles.pdf

<https://www.hsph.harvard.edu/wp-content/uploads/sites/2464/2020/01/FXB-Kosovo-Report-July-2014.pdf>

https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41362&fbclid=IwAR3dQ-Pqx4SldU1pxbW_AQWb7odONQTKGufry4u-7Dqp7C_SbuU38bUuC7k

<https://www.europarl.europa.eu/news/pt/press-room/20220930IPR41930/ending-poverty-and-discrimination-faced-by-roma-people>

<https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/X2H-Xref-ViewHTML.asp?FileID=9676&lang=EN>

https://www.gitanos.org/upload/12/19/guia_ingles.pdf

<https://rm.coe.int/adi-rom-2020-27-final-antigypsyism-causes-prevalence-consequences-poss/1680a6d053>

<https://www.childwatch.uio.no/research/media%20and%20technology/cr%20and%20media.pdf>

<https://www.media-diversity.org/scarcely-debated-rarely-remembered-the-medias-lack-of-roma-representation-could-lead-to-hate-speech/>

<https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-3-on-combating-racism-and-intole/16808b5a29>

<http://www.errc.org/news/romani-children-win-discrimination-case-after-being-denied-entry-to-a-public-swimming-pool-in-romania>

https://www.accioncultural.es/virtuales/vidasgitanas/pdf_eng/vidas_git_art2_representacion_eng.pdf

<https://www.degruyter.com/document/doi/10.7591/9780801467974-015/html>

<http://www.toroidalsnark.net/nextgndi.pdf>

https://www.cjr.org/analysis/diversity_newsrooms_jobs_college_mentorship.php

https://www.cambridge.org/core/services/aop-cambridge-core/content/view/0B4C1709436BE9891F9F12A214E93601/S0269889722000023a.pdf/representing_vulnerable_populations_in_genetic_studies_the_case_of_the_roma.pdf



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo